


NARRATIVAT  
DISINFORMUESE  
RUSE NË MEDIAN  
**SHQIPTARE**





NARRATIVAT DISINFORMUESE  
RUSE NË MEDIAN  
**SHQIPTARE**

Botuar nga: Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri  
Rr. Nikolla Jorga, Nr. 8/8, Tiranë, Shqipëri  
<http://birn.eu.com/>

Autorë: Kristina Voko  
Besar Likmeta

Përktheu: Durim Tabaku

Përkujdesja grafike: Jurgena Tahiri

© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri (Balkan Investigative Reporting Network in Albania - BIRN)  
Tiranë, 2023



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

Ky studim u financua nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri. Opinione, gjetjet, përfundimet apo rekomandimet e shprehura në të janë përgjegjësi tërësisht e Rrjetit Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmëri pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

# PËRMBAJTJA

## I. Konteksti 9

## II. Metodologjia 11

## III. Gjetjet 13

**3.1** Përhapja e shpejtë e disinformimit rus në mediat shqipfolëse 13

**3.2** Dëshifrimi i narrativave pro-Kremlinit që qarkulluan në Shqipëri 15

**3.3** Disinformimi rus në mediat sociale në shqip 27

## IV. Përfundime dhe rekomandime 33

---



## Përkufizime operacionale:

BIRN Shqipëri ka hartuar dy raporte për disinformimin, lajmet e rreme dhe fotot dhe videot e shkëputura nga konteksti që lidhen pushtimin rus të Ukrainës gjatë periudhës janar-gusht 2022. Në këtë raport analizohet se si merren dhe raportohen në mediat dhe rrjetet sociale në gjuhën shqipe lajmet e rreme, të bazuara në falsifikime të qëllimshme, dhe imazhet dhe videot e nxjerra jashtë kontekstit, ndërsa raporti tjetër evidenton ndikimin e disinformimit shtetëror rus dhe përhapjen e tij në mediat standarde dhe ato sociale në gjuhën shqipe. Më poshtë janë renditur disa nga përkufizimet operacionale të termave kryesorë të përdorur për qëllimin e këtij raporti.

**Disinformim:** Informacion i rremë që ka si qëllim mashtrimin, i nxjerrë nga qeveria, shpesh përmes mediave të kontrolluara nga shteti.

**Artikuj disinformues:** Këta janë artikuj, shpesh të botuara fillimisht në media të kontrolluara nga shteti rus, si Sputnik dhe RT, të cilat janë të parat që fusin komente dhe mesazhe të pavërteta në ekosistemin e mediave.

**Raporte për disinformimin:** Këto janë raporteve të verifikimit të fakteve të “artikujve disinformues” nga baza e të dhënave EUvsDisinfo. Këto raporte kanë përgënjeshtuar pretendimet që bëhen në “artikujt disinformues”.

**Narrativa disinformuese:** I referohet narrativave apo tematikave më të përgjithshme të disinformimit nga qeveria ruse në të cilat përmbliidhen disa artikuj. Për shembull, fshehja e mizorive kundër civilëve ukrainas të kryera nga forcat e armatosura ruse.

**Rishpërndarje të informacioneve të rreme:** Ka të bëjë me ribotime të artikujve disinformues në mediat në gjuhën shqipe. Këtu përfshihen raportimet e lajmeve, fotot dhe videot.





# I. Konteksti

---

Gjatë dekadës së fundit, problemi i disinformimit që ka si burim Federatën Ruse është kthyer në një sfidë serioze për Bashkimin Evropian, për shtetet e tij anëtare dhe vendet candidate që synojnë anëtarësimin në të. Shqetësimet për ‘disinformimin rus’ u rritën pas aneksimit të Gadishullit të Krimesë nga Rusia në vitin 2014 dhe pas konfliktit në Donbas, rajon në lindje të Ukrainës, konflikt që është nxitur nga separatistët e mbështetur nga Kremli.<sup>1</sup> Fushatat e ndikimit dhe disinformimit të mbështetura nga Rusia kanë vijuar të zhvillohen, si tematikisht ashtu edhe gjeografikisht, duke synuar proceset demokratike, fushatat elektorale dhe pandeminë globale shëndetësore të shkaktuar nga koronavirusi COVID-19. Kremli ka nxitur trazira sociale, përfshirë këtu fushatën e zgjedhjeve presidenciale në SHBA deri te luftërat e përhershme në Afrikë, duke shpërndarë informacione të shtrembëruara dhe shpesh të rreme përmes ekosistemit mediatik të sponsorizuar nga shteti rus dhe nëpërmjet platformave të mediave sociale.

Komiteti Amerikan i Helsinkit i konsideron fushatat e disinformimit rus si një kërcënim ndërkombëtar për demokracinë, që i hap rrugë shkeljes së normave të OSBE-së (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë) nga regjimi autokratik i Presidentit Vladimir Putin, brenda dhe jashtë vendit në 57 shtetet anëtare të rajonit të OSBE-së.<sup>2</sup> Shkelje të tilla marrin formë të ndryshme, duke filluar nga abuzimet në vend me të drejtat e njeriut në Rusi, ndërhyrjet ushtarake në shtetet fqinje, deri te ndërhyrja në zgjedhje në Shtetet e Bashkuara, në Bashkimin Evropian dhe vende të tjera. Shembulli më i famshëm i një ndërhyrjeje të tillë në zgjedhje mbetet fushata e disinformimit në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në SHBA, ku Rusia mbështeti Donald Trumpin në marrjen e Shtëpisë e Bardhë, duke përhapur emaile të hakuara të Komitetit të Partisë Demokratike.

---

<sup>1</sup> Shfletuesi Ngram i Librave në Google: [https://books.google.com/ngrams/graph?content=Russian+Disinformati on&-year\\_start=1800&year\\_end=2019&corpus=26&smoothing=3](https://books.google.com/ngrams/graph?content=Russian+Disinformati on&-year_start=1800&year_end=2019&corpus=26&smoothing=3), Aksesuar më 28.12.2022

<sup>2</sup> Komisioni për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, ‘Fshikullima e disinformimit rus’, (2017), <https://www.csce.gov/international-impact/events/scourge-russian-disinformation>, Aksesuar më 28.12.2022

Shoqëritë e hapura përballen me sfida për mbrojtjen e integritetit të proceseve të tyre demokratike nga ndikimet dashakeqëse dhe fushatat e disinformimit. Për të përmbushur këtë detyrë, në përputhje me të drejtat themelore, BE-ja ka miratuar një kuadër konkret për të vepruar fuqimisht kundër disinformimit.<sup>3</sup> Vendet kandidatë si Shqipëria, e cila hapi negociatat e anëtarësimit me BE-në në qershor 2022, janë ende duke punuar për të kapur ritmin në këtë drejtim.

Edhe pse Ballkani Perëndimor mbetet një fushëbetejë tensionesh gjeopolitike mes Rusisë dhe Perëndimit, ndikimi i skenarëve të Kremlinit nuk është studiuar ende plotësisht në Shqipëri, e cila shpesh është lënë jashtë listës së vendeve të shënjestruara si objektiv i disinformimit dhe fushata propagandistike të Rusisë. Raportet e mëparshme e kanë përshkruar disinformimin në Shqipëri kryesisht si çështje të brendshme, rezultat i drejtpërdrejtë i një klime të polarizuar politike dhe si efekt anësor i tabloidizimit të mediave në vend dhe i përpjekjeve të tyre për të fituar sa më shumë para nga trafiku online.<sup>4</sup>

Rusia përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të fshehta për të përhapur narrativat e saj dhe për të zgjeruar shtrirjen e fushatave të saj të disinformimit në Perëndim dhe në mbarë botën. Figurat kryesore të fushatave të disinformimit të Rusisë janë mediat e saj të sponsorizuara nga shteti, RT dhe Sputnik. RT ka një rrjet prej tetë kanalesh televizive – i fundit i hapur në Beograd, Serbi – dhe Sputnik kontrollon rreth 30 faqe interneti në gjuhë të ndryshme. Verifikuesit ndërkombëtarë të fakteve dhe ish-gazetarët i kanë identifikuar të dy këto media si furnitorët kryesorë të disinformimeve, lajmeve të rreme dhe teorive konspirative, të ndërtuara me synimin për t'i shërbyer qëllimeve të politikës së jashtme të Kremlinit. As RT dhe as Sputnik nuk kanë transmetime dhe publikime në gjuhën shqipe. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se narrativat ruse, disinformimet

---

<sup>3</sup> Komisioni Evropian, Raport për zbatimin e Planit të Veprimit Kundër Disinformimit, (2019), [https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/joint\\_report\\_on\\_disinformation.pdf](https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/joint_report_on_disinformation.pdf), Aksesuar më 28.12.2022

<sup>4</sup> Parlamenti Evropian, Evidentimi i lajmeve të rreme dhe disinformimeve në Ballkanin Perëndimor dhe identifikimi i formave për t'i luftuar ato me efektivitet, (2021), [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO\\_STU\(2020\)653621\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU(2020)653621_EN.pdf), Aksesuar më 28.12.2022

dhe keqinformimet, të nxitura qoftë nga rrjeti apo nga zyrtarët rusë, nuk arrijnë tek audienca dhe lexuesit shqiptarë nëpërmjet aktorëve të tretë.

## II. Metodologjia

Ky studim ka si qëllim të përcaktojë dhe evidentojë shtrirjen e narrativave pro-Kremlinit në mediat shqiptare duke ndjekur rishpërndarjen e deklaratave dhe lajmeve nga mediat ruse të sponsorizuara nga shteti dhe duke identifikuar mesazhet kryesore. Për qëllimin e këtij studimi, disinformimi përkufizohet si “krijimi dhe shpërndarja e qëllimshme e informacionit të rremë për të manipuluar opinionin dhe perceptimet e publikut.”<sup>5</sup>

Për të hulumtuar përhapjen e narrativave dhe fushatave disinformuese ruse në mediat në gjuhën shqipe, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri (BIRN Albania) u mbështet në bazën e të dhënave të lajmeve disinformuese të mbështetura nga Rusia, të publikuar nga Task Forca Lindore e Stratcom e EEAS në bazën kryesore të të dhënave EUvsDisinfo. E krijuar në vitin 2015, Task Forca Lindore e Stratcom monitoron dhe punon për rritjen e ndërgjegjësimit për fushatat e disinformimit të Kremlinit duke përpiluar dhe ekspozuar raste përmes monitorimit dhe analizës së mediave në 15 gjuhë, të mbledhura në një bazë të dhënash me burim të hapur me më shumë se 14,700 shembuj të disinformimit rus.<sup>6</sup>

Periodha e marrë në studim për këtë hulumtim përfshin tetë muajt e parë të vitit 2022 (janar-gusht), që

---

<sup>5</sup> Instituti Demokratik Kombëtar, “Disinformimi dhe Integriteti Zgjedhor”, (2019), [https://www.ndi.org/sites/default/files/Disinformation%20and%20Electoral%20Integrity\\_NDI\\_External\\_Updated%20May%202019%20%281%29.pdf](https://www.ndi.org/sites/default/files/Disinformation%20and%20Electoral%20Integrity_NDI_External_Updated%20May%202019%20%281%29.pdf), Aksesuar më 27.10.2022.

<sup>6</sup> Euvdisinfo.com, Rreth nesh, (2022), <https://euvdisinfo.eu/about/>, Aksesuar më 28.12.2022.

përputhet me pushtimin e Ukrainës nga Rusia. Gjatë kësaj periudhe, baza e të dhënave EUvsDisinfo ka identifikuar dhe listuar 384 raste artikujsh disinformues. Për secilin prej këtyre rasteve u identifikuan fjalë kyçe, terma kërkimi dhe fraza, u përkthyen dhe u përdorën teknika kërkimi të hapura, për të kërkuar botimin e tyre në gjuhën shqipe. Edhe pse qëllimi kryesor i hulumtimit ishte identifikimi dhe hartëzimi i përhapjes së informacioneve të rreme në Shqipëri, në mediat në gjuhën shqipe nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut si dhe nga diaspora apo mediat ndërkombëtare me shërbime në gjuhën shqipe - të cilat kanë lexues edhe në vend, u mbledhën të dhëna edhe nga këto media.

Të dhënat e mbledhura nga hulumtuesit u hodhën në një fletë pune në Excel, ku u futën edhe adresat online të publikimit në gjuhën shqipe, datat, emri i medias, lloji i medias, si dhe shteti ku ka qendrën media. Duke u mbështetur në bazën e të dhënave të krijuar, artikujt e identifikuar në gjuhën shqipe u analizuan dhe u koduan bazuar në narrativat disinformuese ruse të identifikuara nga baza e të dhënave EUvsDisinfo.

BIRN Albania përdori bazën e të dhënave EUvsDisinfo për një sërë arsyesh. Së pari, sepse verifikimi nga kjo bazë të dhënash i deklaratave dhe narrativave të publikuara nga mediat e sponsorizuara nga shteti rus mbulon në vijimësi periudhën e hulumtuar, janar - gusht 2022. Së dyti, për shkak të mungesës së shërbimeve të verifikimit të fakteve në Shqipëri të fokusuara në monitorimin e përhapjes së dezinformatave dhe narrativave ruse në gjuhën shqipe, lindi nevoja e përdorimit të një burimi të jashtëm të dhënash. Së treti, numri i deklaratave të verifikuara në bazën e të dhënave EUvsDisinfo përfshin një kampion të konsiderueshëm, çka mundëson vlerësimin e përhapjes së tyre në mediat në gjuhën shqipe, si dhe krahasimet e ardhshme në kohë dhe hapësirë gjeografike.

Krahas informacioneve të rreme të identifikuara në mediat në gjuhën shqipe, hulumtuesit analizuan edhe postimet e bëra në faqen zyrtare në Facebook të Ambasadës së Federatës Ruse në Tiranë në tetë muajt e parë të vitit 2022 për të identifikuar mesazhet e përsëritura disinformuese ruse të përhapura përmes këtij kanali të medias sociale.

BIRN Albania përdori softuerin Crowdtangle për të matur angazhimin e përdoruesve të mediave sociale me mesazhet disinformuese ruse të publikuara nga kjo llogari gjatë tetë muajve të parë të vitit 2022.

*Kufizimet:* Numri i mesazheve ruse dhe shpërndarja e tyre në mediat në gjuhën shqipe për periudhën janar-gusht 2022 ka të ngjarë të jetë shumë më i madh se ai i identifikuar nga ky studim për shkak të kufizimeve të metodologjisë së mëposhtme. Së pari, për qëllimin e këtij studimi, narrativat disinformuese në mediat në gjuhën shqipe bazohet vetëm tek ato të identifikuara nga baza e të dhënave EUvsDisinfo. Së dyti, për shkak të mbledhjes së të dhënave retrospektive, numri i mesazheve propagandistike të identifikuara është i kufizuar në artikuj dhe video, pa mbuluar shpërndarjen e tyre në formate të tjera mediatike, si në edicionet e lajmeve dhe debatet në mediat audiovizive. Së treti, të dhënat për angazhimin në rrjetet sociale u mblodhën gjatë periudhës së hulumtimit gusht-tetor 2022 dhe janë subjekt i ndryshimeve të vogla (për ato që mund të rishihen), sepse për postimet, fotot dhe videot në mediat sociale me kalimin e kohës në mënyrë të vazhdueshme regjistrohen ndërveprime të reja. Gjithsesi, pjesa dërrmuese e ndërveprimeve regjistrohen në mediat sociale në 48 orët e para pas publikimit.

### III. Gjetjet

#### 3.1 Përhapja e shpejtë e disinformimit rus në mediat shqipfolëse


Hulumtimi në mediat lokale mbi narrativat ruse të disinformimit u bazua në listën e rasteve të informacioneve të rreme të shpërndara nga ekosistemi i mediave të Kremlinit dhe të publikuar në bazën e të dhënave EUvsDisinfo në tetë muajt e parë të 2022. Nga 384 rastet e disinformimeve të përgënjeshtuara nga EUvsDisinfo përmes monitorimit të mediave në 15 gjuhë gjatë periudhës janar - gusht 2022, 86 prej tyre (22 për qind) u shpërndanë nga mediat në gjuhën shqipe në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Pjesa më e madhe e rasteve të identifikuara të narrativave ruse që qarkulluan në mediat në gjuhën shqipe gjatë periudhës së këtij studimi u publikuan në disa media. Hulumtuesit mundën të identifikonin gjithsej 377 artikuj dhe video që përmbanin informacione të rreme të servitura nga Rusia. Më shumë se 65 për qind e këtyre artikujve u botuan nga mediat në gjuhën shqipe në Shqipëri, 19 për qind nga mediat në gjuhën shqipe në Kosovë, 9 për qind nga mediat shqipfolëse në Maqedoninë e Veriut dhe 7 për qind e mbetur

nga agjenci lajmesh të sponsorizuara nga shteti në Iran dhe Turqi me shërbime dhe faqe interneti në gjuhën shqipe.

**Figura 1**

**NUMRI I RISHPËRNDARJEVE TË ARTIKUJVE DISINFORMUES NË MEDIAT NË GJUHËN SHQIPE SIPAS SHTETIT**



Në total 156 media në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut publikuan në tetë muajt e parë të vitit 2022 artikuj që përmbanin lajme të rreme ruse. Nga ky grup, vetëm katër media kishin dhjetë ose më shumë artikuj të botuar, ndërsa 152 mediat e tjera kishin më pak se dhjetë lajme.

Pjesa më e madhe e narrativave disinformuese të publikuara në mediat në gjuhën shqipe qarkulluan në portalet e lajmeve, të cilat përbënin 61 për qind të totalit, të ndjekura nga faqet online të televizioneve (19 për qind) dhe gazetave (12 për qind), faqet e internetit të agjencive të lajmeve (5 për qind) dhe faqet e stacioneve radiofonike dhe revistave (3 për qind). Shumica dërmuese e tyre ishin artikuj të shkruar dhe vetëm në katër raste ato u shfaqën si video në YouTube.

### 3.2 Dëshifrimi i narrativave pro-Kremlinit që qarkulluan në Shqipëri


Që kur Rusia pushtoi Ukrainën në shkurt të vitit 2022, ekosistemi i mediave të Kremlinit ka qarkulluar një sërë lajmesh të rreme që lidhen me konfliktin, disa prej të cilave janë përhapur edhe në Shqipëri. Analiza cilësore e përmbajtjes tregon se të 86 artikujt disinformues evidentuar nga baza e të dhënave EUvsDisinfo janë kapur në mediat shqiptare lidhur me pushtimin rus në Ukrainë. Këta 86 artikuj disinformues, të cilët u ribotuan dhe rishpërndanë gjithsej 377 herë, mund të grupohen në 31 narrativa të ndryshme të përsëritura me mesazhe pro-Kremlinit.

Dhjetë narrativat më të zakonshme pro-Kremlinit që qarkulluan gjatë periudhës janar-gusht 2022 përbëjnë 69 për qind të artikujve të botuar në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë me lajme të rreme nga Rusia.

Më poshtë po rendisim dhjetë narrativat më të qarkulluara në mediat në gjuhën shqipe gjatë tetë muajve të parë të vitit 2022.

Figura 2

## NUMRI I ARTIKUJVE DHE RIPUBLIKIMEVE TË REGJISTRUARA PËR NARRATIVAT KRYESORE PRO-KREMLINIT NË MEDIAT NË GJUHËN SHQIPE





## Fshehja e mizorive të kryera nga forcat e armatosura ruse kundër civilëve në Ukrainë

**Lavrov: Filloi faza e re e operacionit special në Ukrainë, ne po prekim vetëm infrastrukturën ushtarake, jo civilët! S'duam të ndryshojmë regjimin e Kievit**

Lajme

**Mizoritë në Bucha janë “operacion special britanik”, thotë Lukashenko**

**Rusia mohon sulmin në stacionin hekurudhor: Ukraina dëshiron të përdorë civilët si mburojë njerëzore**

Gjatë periudhës janar-gusht 2022, në mediat në gjuhën shqipe janë botuar 13 artikuj, me gjithsej 50 ripublikime ku në thelb kishin mesazhin e mësipërm. Qëllimi kryesor i këtyre artikujve duket se është të bëjë përpjekje për të kundërshtuar dhe për të larguar vëmendjen nga provat e publikuara nga autoritetet ukrainase për krimet e kryera nga trupat ruse në qytetin e Buchas gjatë ofensivës së Kievit. Përpjekje e ngjashme u bë përmes publikimit të historive që synojnë të largojnë përgjegjësinë nga forcat ruse për një sulm me raketa në një qendër tregtare në qytetin Kremenchuk më 27 qershor 2022 ku u vranë 21 vetë dhe u plagosën 66 të tjerë. Një tjetër histori, por me të njëjtin mesazh, tentonte t'ia hidhte përgjegjësinë forcave ukrainase për sulmin me raketa ndaj civilëve ukrainas në qytetin Kramatorsk më 11 prill 2022. Ndryshe nga këto pretendime të mediave pro-Kremlinit, stacioni hekurudhor Kramatorsk besohet se është sulmuar nga forcat ruse, ku u vranë 57 civilë dhe u plagosën 115 të tjerë. Në një tjetër artikull me të njëjtin mesazh të përsëritur pretendohet se forcat ukrainase po përgatishnin një operacion “me flamur të rremë” në termocentralin bërthamor të Zaporizhzhias, ndërkohë që pretendohet se krimet e kryera në qytetin e Buchas ishin një operacion “me flamur të rremë” nga forcat ukrainase.

## Narrativa e përsëritur e disinformimit që përlligj pushtimin rus të Ukrainës

**"Sanksionet dëmtojnë më shumë ato që i vendosin", Putin: SHBA përpiqet të izolojë shtetet e gabuara**

17 Qershor, 2022 15:29

BOTA

**Ambasadori rus në Britaninë e Madhe thotë se akuzat për krime lufte janë fabrikime**

**Lavrov: Perëndimi është përgjegjës për vdekjen e civilëve në Ukrainë**

"Perëndimi duhet të kuptojë se është përgjegjës për vdekjet e civilëve, veçanërisht në rajonin e Donbasit dhe rajone të tjera të Ukrainës", tha ministri i Jashtëm rus, Lavrov

Hulumtuesit mundën të identifikonin tetë artikuj, të botuar 12 herë në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë që përmbanin këtë narrativë disinformuese pro-Kremlinit. Në këtë narrativë përfshiheshin artikuj që tentonin në mënyrë të vazhdueshme të përlligjinin veprimet ushtarake të Rusisë në Ukrainë duke pretenduar se Perëndimi dhe Ukraina ishin përgjegjëse për luftën. Historitë e publikuara nën këtë narrativë disinformuese pretendonin se Rusia nuk kishte zgjidhje tjetër veçse të niste të ashtuquajturin "operacion special ushtarak", sepse Ukraina dhe Perëndimi kishin planifikuar një ofensivë ushtarake kundër popullsisë ruse që jetonte në rajonin e Donbasit. Dy nga historitë që nxisin të njëjtën narrativë ngrinin pretendime të rreme se pushtimi i Ukrainës nga Rusia ishte në përputhje me kartën e Kombeve të Bashkuara. Më 2 mars 2022, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi një rezolutë me të cilën dënonte pushtimin rus të Ukrainës.

## NATO/SHBA janë agresive dhe kërcënim për Rusinë

Bota

Rusia: Zgjerimi i NATO-s do të rrisë tensionet në Europë

NATO është një bllok agresiv, tha Kremli

Lavrov paralajmëron NATO-n: Ndiheja juaj në Ukrainë, rrezik për një luftë të tretë botërore

22:25 | 25/04/2022 | në Bota

Në narrativën e tretë pro-Kremlinit më të qarkulluar në mediat në gjuhën shqipe gjatë tetë muajve të parë të vitit 2022, NATO-ja dhe Shtetet e Bashkuara përshkruhen si kërcënim për Federatën Ruse për të përligjur pushtimin e Ukrainës. Kjo narrativë përshkruan NATO-n, që është një aleancë mbrojtëse e shteteve demokratike, si një bllok ushtarak agresiv që synon të përballet me Rusinë, duke u afruar dalëngadalë drejt kufijve të saj që me rënien e Bashkimit Sovjetik. Në kuadër të kësaj narrative, hulumtuesit mundën të identifikonin tetë artikuj disinformues, të cilët u ribotuan gjithsej 32 herë nga mediat në gjuhën shqipe.

## Shmangia e përgjegjësisë për përkeqësimin e krizës ushqimore në botë

Rusia / Ukraina po paguan armët perëndimore me grurë

BOTA

**Kriza globale, Rusia mohon gjithçka dhe akuzon ashpër Perëndimin: Po përpiqen të imponojnë...**

*Sanksionet ndaj Rusisë, Kremli: Perëndimi shkaktoi krizën globale të ushqimit*

Në një tjetër narrativë disinformuese pro-Kremlinit që qarkulloi gjatë tetë muajve të parë të vitit 2022, bëheshin përpjekje për të larguar fajin për krizat globale të ushqimit, duke argumentuar se kjo nuk vjen si pasojë e bllokadës dhe pushtimit të Ukrainës nga Rusia dhe bombardimeve të infrastrukturës së saj, por përkundrazi nga politikat ekonomike populiste të Perëndimit. Në kuadër të kësaj narrative janë publikuar tetë artikuj disinformues në tetë muajt e parë të vitit 2022, ku u regjistruan në total 42 ripublikime në mediat në gjuhën shqipe në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Në këto artikuj ngrihej pretendimi i rremë se Perëndimi i dha armë Ukrainës në këmbim të eksportit të furnizimeve me ushqime. Në këtë mënyrë, narrativa disinformuese synonte të shmangte hedhjen e fajit të Rusia për ndikimin që kishte pushtimi i saj në sigurinë globale të ushqimit.

## Perëndimi po pengon përpjekjet e paqes në Ukrainë

**Lavrov: Perëndimi nuk e lejon Ukrainën të zhvillojë negociatën me Rusinë**

Kryediplomati rus tha se sanksionet ekonomike po e dëmtojnë Perëndimin më shumë se Rusinë

Bota

**Lavrov: SHBA dhe Britania e Madhe duan ta shtyjnë Rusinë kundër Evropës**

**“NATO, me qëllime imperialiste”,  
Putin: Operacioni në Ukrainë, sipas  
parashikimeve**

Një tjetër fushatë me informacione të rreme që u përhapën nga ekosistemi mediatik i financuar nga Kremli dhe që gjetën hapësirë në mediat në gjuhën shqipe në tetë muajt e parë të 2022 ishte pretendimi i rremë se vendet perëndimore po minonin përpjekjet për arritjen e paqes mes Rusisë dhe Ukrainës. Hulumtuesit mundën të identifikonin pesë artikuj disinformues me gjithsej 28 ripublikime gjatë periudhës janar-gusht 2022. Kjo është një narrativë disinformues e përsëritur nga mediat pro-Kremlinit ku pretendohet se Perëndimi po dëmton përpjekjet për paqe në Ukrainë dhe se qëllimi i tij i vërtetë është të përhapë ndikimin e tij në rajon në dëm të interesave ruse.

## Armë biologjike dhe pretendime për laboratorë biologjikë sekretë në Ukrainë

**“Hunter Biden lidhje me kompaninë Metabiota që dyshohet për biolaboratorët në Ukrainë – Daily Mail**

Rusia akuzon SHBA dhe Ukrainën: Po bashkëpunojnë për armët kimike

**Maria Zakharova: Gjermania e përfshirë në “aktivitetet bio-ushtarake” në Ukrainë**

Prania e laboratorëve të armëve biologjike në Ukrainë, që pretendohet se drejtohen apo financohen nga SHBA dhe Gjermania, është një tjetër fushatë e preferuar mediatike disinformimi pro-Kremlinit që synon të përliqjë vendimin e Vladimir Putinit për të pushtuar fqinjin e tij. Hulumtuesit mundën të identifikonin katër histori me gjithsej 15 ripublikime gjatë periudhës janar-gusht 2022, të cilat përmbanin mesazhin e mësipërm disinformues. Artikulli më i përhapur ishte ai që lidhte Hunter Biden, djalin e presidentit amerikan Joe Biden, me laboratorët e dyshuar të armëve biologjike në Ukrainë. Kjo narrativë disinformuese synon të diskreditojë dhe fyejë familjen e presidentit amerikan. Kombet e Bashkuara kanë deklaruar se nuk ka dëshmi për praninë e laboratorëve të tillë me armë biologjike në territorin e Ukrainës. Pretendimet për laboratorët e supozuar të armëve biologjike në Ukrainë janë përdorur, nga ana tjetër, për të fshehur krimet dhe abuzimet me të drejtat e njeriut nga forcat ruse.

## Ukraina po merret në kontroll nga neonazistët

Lajme

Rusia akuzon Francën për nxitje të neo-nazizmit

Lajme

Denazifikimi sipas Moskës: Do të zgjasë 25 vjet, punë e detyruar, të zhduket emri Ukrainë

Rusia akuza Izraelit për mbështetje të neo-nazistëve në Ukrainë

Një nga narrativat më të përhapura pro-Kremlinit që hulumtuesit mundën të identifikonin në mediat në gjuhën shqipe në tetë muajt e parë të vitit 2022, propagandë që synonte të justifikonte pushtimin rus, është pretendimi i rremë se Ukraina ka një udhëheqje neonaziste. Hulumtuesit patën mundësinë të identifikonin pesë artikuj disinformues dhe 28 ripublikime në mediat në gjuhën shqipe në suazën e kësaj narrative. Pretendimi i rremë më i përhapur lidhej me pretendimet ruse se Tel Avivi po mbështet një regjim neonazist në Kiev. Ky pretendim i rremë thuhet se është shpërndarë në përpjekje për të larguar vëmendjen nga një deklaratë tjetër që kishte bërë Ministri i Jashtëm rus Sergey Lavrov, i cili tha për hebrenjtë se janë antisemitët më të këqij, si pjesë e sulmeve të tij kundër presidentit ukrainas Volodymyr Zelenskyy. Në një tjetër histori nën të njëjtën narrativë disinformuese ngrihen pretendime se Franca po nxit nacionalizmin dhe neonazizmin ukrainas. Ky pretendim i rremë përdoret për të justifikuar pushtimin rus të Ukrainës.

## Ambiciet perandorake të Polonisë

Kreu i inteligjencës ruse: Polonia dhe SHBA do të pushtojnë Ukrainën perëndimore

Zëdhënësi i Kremlinit kritikon retorikën e Polonisë kundër Rusisë

**Inteligjenca ruse: Ukraina ka rënë dakord të aneksohet nga Polonia**

Një tjetër narrativë disinformuese pro-Kremlinit që ka qarkulluar në Shqipëri në tetë muajt e parë të vitit 2022 përqendrohet në pretendimin e rremë se Polonia ka ambicie perandorake për të aneksuar Ukrainën perëndimore. Hulumtuesit mundën të identifikonin katër artikuj me gjithsej 13 ripublikime gjatë periudhës janar-gusht 2022, të cilët kishin në fokus këtë mesazh. Etiketimi i Polonisë si shtet me ambicie perandorake është një propagandë e përsëritur në kanalet ruse të disinformimit. Me këtë pretendim bëhen përpjekje për të shfrytëzuar ndasitë në historinë polake-ukrainase për të ringjallur kërcënimin e shpërbërjes së Ukrainës.



## Perëndimi armiqësor/rusofob po synon të rrethojë Rusinë

Statusi kandidat për Ukrainën dhe Moldavinë, zëdhënësja ruse: Liderët e BE-së nuk mendojnë pasojat negative

Lavrov: Perëndimi i ka shpallur luftë totale botës ruse

**Putin e Lavrov thonë se Perëndimi s'mund t'i bëjë gjë Rusisë (VIDEO)**

Një tjetër narrativë disinformuese ruse shumë e përhapur që u identifikua në mediat në gjuhën shqipe nga hulumtuesit është pretendimi se një Perëndim armiqësor po përpiqet të rrethojë Rusinë duke zgjeruar ndikimin e tij në sferën ish-sovjetike. Hulumtuesit identifikuan tre artikuj disinformues të botuar gjithsej 29 herë si pjesë e kësaj propagande pro-Kremlinit gjatë tetë muajve të parë të 2022. Në këta artikuj hidhen akuza kundër vendeve perëndimore për rusofobi, që është një narrativë disinformuese e përsëritur nga mediat pro-Kremlinit.

## Humbja e sovranitetit të shteteve anëtare të BE-së

Kreu i Dumës ruse: SHBA e ka dënuar Europën  
me uri, të ftohtë dhe izolim

**“Asgjë nuk do jetë si më parë!”/ Tërbohet Vladimir  
Putin – ‘kërcënon’ Amerikën dhe Perëndimin**

**Putin: BE ka humbur plotësisht sovranitetin**

Një tjetër narrativë e përhapur nga ekosistemi mediatik i Kremlinit dhe që qarkulloi edhe në mediat në gjuhën shqipe është se SHBA-të kontrollojnë politikën e jashtme të BE-së dhe të shteteve anëtare të saj. Kjo propagandë e përsëritur disinformuese pro-Kremlinit pëlqen ta portretizojë vendimin e vendeve të BE-së për të vendosur sanksione ndaj Rusisë si thjesht zbatim të urdhrave të Shteteve të Bashkuara. Hulumtuesi mundën të identifikonin dy artikuj disinformues me 10 ripublikime si pjesë e kësaj narrative në tetë muajt e parë të 2022 në mediat në gjuhën shqipe në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

### 3.3 Disinformimi rus në mediat sociale në shqip


Përveç informacioneve të rreme të shpërndara nga ekosistemi mediatik pro-Kremlinit, hulumtuesit analizuan edhe postimet dhe mesazhet e Ambasadës së Federatës Ruse në Tiranë gjatë tetë muajve të parë të vitit 2022. Gjatë kësaj periudhe, Ambasada Ruse ka bërë 322 postime në Facebook në shqip, anglisht dhe rusisht. Rreth 76 për qind e këtyre postimeve ishin foto të shoqëruara me tekste, të ndjekura nga adresa në internet dhe video. Nga 322 postime, 303 e tyre përmbanin mesazhe me tekst që u morën në analizë nga hulumtuesit për informacione të rreme dhe u kategorizuan, ndonëse ishin identifikuar më parë si tema të përsëritura të narrativave disinformuese ruse.

Hulumtuesit identifikuan 127 postime me informacione të rreme.

Rreth 74 për qind e postimeve me narrativa disinformuese erdhën nga deklaratat e bëra nga Ministria e Jashtme e Rusisë, Ministria e Mbrojtjes, Presidenti rus Vladimir Putin, Ministri i Jashtëm Sergey Lavrov dhe zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme Maria Zakharova. Hulumtuesit mundën të identifikonin 15 raste të ndryshme me informacione të rreme në postimet e institucioneve dhe zyrtarëve rusë të postuara në faqen në Facebook të Ambasadës së Federatës Ruse në Shqipëri. Më e përsëritur ndër to, e evidentuar në 33 për qind të postimeve të ambasadës ruse në Shqipëri në tetë muajt e parë të vitit 2022, ishte “Fshehja e mizorive të kryera nga forcat e armatosura ruse kundër civilëve në Ukrainë”. E dyta për nga shpeshtësia e përsëritjes, me 15 për qind të postimeve, kishte për qëllim ta përshkruante “NATO-n/ShBA-të si agresive dhe kërcënim për Rusinë”, ndërsa grupi i tretë me 13 për qind të mesazheve pro-Kremlinit ishte “Narrativa e përsëritur e disinformimit që përlligj pushtimin rus të Ukrainës”, mesazh që përpiqet të përlligjë pushtimin e Ukrainës shpesh me pretendimin e një sulmi të mundshëm nga Kievi ndaj republikave separatiste Donetsk dhe Luhansk.

### Grafiku 3

#### NUMRI I POSTIMEVE ME PËRMBAJTJE DISINFORMUESE NË MEDIAT SOCIALE TË AMBASADËS SË RUSISË NË SHQIPËRI



**DIS**  
**INFO**  
AL

www.disinfo.al

Sipas të dhënave nga Crowdtangle, për 127 postime me informacione të rreme u regjistruan 11,409 ndërveprime, të cilat përkufizohen si reagime, komente dhe rishpërndarje në formën e postimeve, fotove dhe videove. Ndërveprimet njihen edhe me termin 'angazhim'<sup>7</sup>. Ky numër i lartë ndërveprimesh sugjeron që këto postime kanë arritur te një numër i madh njerëzish shqiptolës që i kanë parë ose lexuar ato.

<sup>7</sup> Crowdtangle, "Të kuptojmë dhe citojmë të dhënat e CrowdTangle", (2022), <https://help.crowdtangle.com/en/articles/4558716-understanding-and-citing-crowdtangle-data>, Aksesuar më 6.11.2022.

## RAST STUDIMOR: Mercenarë shqiptarë në Ukrainë

Përveç informacioneve të rreme ruse të identifikuar në bazën e të dhënave EUvsDisinfo nga Stratcom i BE-së, në këtë raport analizohet edhe një deklaratë e Ministrit të Jashtëm rus Sergey Lavrov për praninë në Ukrainë të mercenarëve shqiptarë dhe shqiptarëve të Kosovës. Këto pretendime u transmetuan nga mediat lokale dhe përbëjnë një propagandë pro-Kremlinit që synon të justifikojë pushtimin e fqinjit të tij. Në një intervistë për televizionin RT më 18 shkurt 2022, Lavrov deklaroi se autoritetet ruse po shqyrtonin disa raporte se në Donbas po dërgoheshin mercenarë nga Kosova, Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina.<sup>8</sup>


“Kemi informacione se militantë nga Kosova, Shqipëria dhe Bosnje Hercegovina po rekrutohen për të luftuar kundër Ruisë, duke i dërguar ata në Donbas [në lindje të Ukrainës]. Aktualisht po punojmë për t’i verifikuar këto informacione,” i tha Lavrov televizionit RT.<sup>9</sup>

Ky pretendim i Lavrovit u bë mes tensionesh në rritje në prag të pushtimit rus të Ukrainës dhe u përcoll nga shumë media në gjuhën shqipe. Hulumtuesit në këtë studim mundën identifikonin 112 lajme në mediat në gjuhën shqipe gjatë periudhës 18-24 shkurt 2022, të cilat i referoheshin pretendimit të Ministrit të Jashtëm rus. Këta artikuj janë botuar në 69 media në gjuhën shqipe në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Ndonëse pjesa më e madhe e artikujve citonin thjesht deklaratën e Lavrovit për RT, disa nga këta artikuj u pasuan nga reagime nga Ministria e Jashtme e Shqipërisë, Ministria

<sup>8</sup> TASS, “Rusia po shqyrton raporte për mercenarë nga Kosova, Shqipëria, Bosnje Hercegovina për Donbasin - Lavrov”, (2022), <https://tass.com/world/1406183>, Aksesuar më 07.01.2023.

<sup>9</sup> Russia Today, “Fushata e NATO-s e bëri rajonin e Evropës “vatër të krimi” - Lavrov për RT”, (2022), <https://www.rt.com/russia/549845-lavrov-nato-yugoslavia-kosovo/>, Aksesuar më 07.01.2023.

e Jashtme Olta Xhaçka, ish-Kryeministri Pandeli Majko apo ish-Ministri i Jashtëm Paskal Milo. Për 112 postimet në Facebook që u bënë nga 69 media që i referoheshin dhe kundërshtonin deklaratën e Lavrovit, u regjistruan gjithsej 2,318 ndërveprime. Video reportazhet e lajmeve të bazuara në deklaratën e Lavrovit morën dhjetëra mijëra shikime në YouTube.

 Embassy of Russia in Albania / Посольство России в Албании  
June 18, 2022 · 🌐

Ministria e Mbrojtjes e Rusisë ka publikuar statistikat e plota për mercenarët e huaj që luftojnë në Ukrainë

Lexoni versionin e plotë të dokumentit: <https://eng.mil.ru/.../Number%20of%20foreign...>

### NUMBER OF FOREIGN MERCENARIES IN UKRAINE

Country	Arrived since 24.02.22	Eliminated	Departed	Total on 17.06.22
<b>Europe</b>				
Poland	1831	378	272	1181
Romania	504	102	98	304
United Kingdom	422	101	95	226
Croatia	204	74	51	79
Belarus	197	69	59	69
France	183	59	45	79
Bosnia and Herzegovina	167	51	46	70
Estonia	164	55	49	60
Kosovo	156	61	60	35
Albania	150	42	40	68
Lithuania	130	50	44	36
Portugal	103	19	16	68

E njëjta akuzë u bë edhe në qershor 2022, kur Ambasada e Federatës Ruse në Tiranë ripostoi një deklaratë të Ministrisë së Mbrojtjes së Rusisë në faqen e saj në Facebook për numrin e pretenduar të mercenarëve të huaj që luftonin në Ukrainë. Në postim jepej një tabelë me të dhëna për numrin e mercenarëve të dyshuar nga vende të ndryshme si dhe deklaratën: “Ministria ruse e Mbrojtjes ka publikuar statistikat e plota për mercenarët e huaj që luftojnë në Ukrainë”. Ministria e Mbrojtjes e Rusisë pretendonte se në Ukrainë kishin shkuar 150 mercenarë nga Shqipëria, nga të cilët 42 ishin vvarë tashmë.

Postimi nga Ambasada e Federatës Ruse në Shqipëri u mor nga 25 media në

gjuhën shqipe. Sipas të dhënave nga Crowdtangle, në total në Facebook për këta artikuj u regjistruan 1,568 ndërveprime. Një nga postimet ishte një artikull që e përgënjeshtroi informacionin e postuar

nga Ambasada Ruse si të rremë. Ai është publikuar nga shërbimi lokal i verifikimit të fakteve Faktoje.<sup>10</sup> Shërbimi i verifikimit të fakteve citon në artikull Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, e cila thotë: “Nuk ka asnjë provë që shtetas shqiptarë të kenë shkuar për të luftuar si mercenarë në Ukrainë.”

## RAST STUDIMOR: Raketa “Javelin” dhe targat shqiptare

### VIDEO/ Raketat “Javelin” bien në duar të shqiptarëve, shiten në tregun e zi

21:20 : 13/07/2022 në AKTUALITET, BOTA, KRONIKE



Një tjetër rast i disinformimit rus që kishte si synim të drejtpërdrejtë Shqipërinë ishte publikimi i një videoje që pretendonte se tregonte trafikun e supozuar të raketave antitank ‘Javelin’ nga Ukraina në tregun e paligjshëm të armëve në Ballkan. Videoja u shpërnda për herë të parë më 13 korrik 2022, nga një llogari në Twitter e quajtur AZmilitary1 dhe pretendohet se ishte regjistrim me video i shitjes së disa armëve që i ishin dhënë Ukrainës nga NATO-ja. Në klipin prej 85 sekondash tregohet një automjet Volkswagen me targa të Shqipërisë, ku dy burra shtrëngonin duart si dhe bagazhin e makinës me arka raketash.<sup>11</sup>

<sup>10</sup> Faktoje, “Debunking/ 42 nga 150 mercenarë shqiptarë janë vrarë në Ukrainë Institucionet zyrtare: Deklarata është e pavërtetë”, (2022), <https://faktoje.al/debunking-42-nga-150-mercenare-shqiptare-jane-vrare-ne-ukraine-institucionet-zyrtare-deklarata-eshte-e-pavertete/>, Aksesuar më 07.01.2023.

<sup>11</sup> Newsweek, “Postimet me informacione të rreme flasin për propagandën e Rusisë për ‘kontrabandë’ armësh në Ukrainë,” (2022), <https://www.newsweek.com/misleading-posts-russia-ukraine-weapons-smuggling-propaganda-newsweek-fact-check-1725107>, Aksesuar më 07.01.2023.

Sipas revistës amerikane Newsweek, videoja duket që është e rreme, sepse është postuar nga një llogari e paverifikuar në Twitter, pa të dhëna për vendndodhjen gjeografike, kohën e publikimit apo të dhëna të tjera që mund të shërbenin për të forcuar besueshmërinë e saj. Ndonëse llogaria në Twitter duket se është anonime, ajo ndiqet nga një sërë llogarish propagandistike pro-Kremlinit. Po ashtu, targa e supozuar shqiptare që shfaqet në video (AA851EE), sipas bazës së të dhënave të targave të Shqipërisë i përket një automjeti Mercedes Benz.<sup>12</sup>

Megjithatë, para se të përgënjeshtrohej si e pavërtetë, videoja u qarkullua në disa media në gjuhën shqipe, me kryetituj që pretendonin për trafik raketash Javelin.<sup>13</sup>

---

<sup>12</sup> Faktor.al “Si depërtoi Rusia në mediat shqiptare me një video fakenews!” (2022), <https://www.faktor.al/2022/07/15/si-depërtoi-rusia-ne-mediat-shqiptare-me-njevideo-fakenews/>, Aksesuar më 07.01.2023.

<sup>13</sup> Newsbomb.al, “Raketa JAVELIN në tregun e zi, makina me TARGA SHQIPTARE bën “trafik armësh” në UKRAINË (VIDEO)”, <https://newsbomb.al/raketa-javelin-ne-tregun-e-zi-makina-me-targa-shqiptare-ben-trafik-armesh-ne-ukraine-video/>, Aksesuar më 07.01.2023



## IV. Përfundime dhe rekomandime

Pavarësisht faktit se mediat ruse të sponsorizuara nga shteti nuk publikojnë lajme në gjuhën shqipe, të dhënat e hulumtimit tregojnë se gjatë vitit 2022 në mediat në gjuhën shqipe kanë qarkulluar narrativa disinformuese pro-Kremlinit, veçanërisht në lidhje me pushtimin rus të Ukrainës. Në mediat në gjuhën shqipe në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut gjatë periudhës janar-gusht 2022 u qarkulluan gati një në katër lajme të përgënjeshtuara nga EUvsDisinfo. Një përqindje e tillë e informacioneve të rreme ose të shtrembëruara ruse të identifikuara të publikuara në mediat në gjuhën shqipe është mjaft e lartë kur merret parasysh që baza e të dhënave EUvsDisinfo përfshin të dhëna nga shërbimet e monitorimit të mediave në 15 gjuhë, por që nuk përfshin gjuhën shqipe. Qarkullimi i lartë i informacioneve të rreme ruse gjatë kësaj periudhe në mediat në gjuhën shqipe përkon me pushtimin rus në Ukrainë, një temë që është pasqyruar gjerësisht në mediat në vend.

Nga gjetjet e këtij hulumtimi konstatohet se 86 artikujt disinformues që kanë qarkulluar në mediat në gjuhën shqipe janë ripublikuar gjerësisht, duke regjistruar gjithsej 377 artikuj dhe video që përmbanin informacione të rreme ruse. Këta artikuj janë botuar nga 156 media, pjesa më e madhe e të cilave janë me qendër në Shqipëri dhe të tjerat në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Këto të dhëna sugjerojnë se nuk ka ndikim të qartë ideologjik në përhapjen e informacioneve të rreme ruse nga një grup i vogël mediash që janë pjesë e një operacioni të fshehtë influence. Ka më shumë gjasa që narrativat pro-Kremlinit të kalojnë në mediat lokale nga ekosistemi mediatik rus ose ripublikime nga media të tjera të huaja. Një shqetësim lidhet me numrin e lajmeve (19) të publikuara nga agjenci lajmesh të sponsorizuara nga shteti në Iran dhe Turqi me shërbime dhe faqe interneti në gjuhën shqipe, gjë që sugjeron se ato po përforcojnë disa nga historitë me informacione të rreme nga Rusia.

Edhe pse Shqipëria mund të mos jetë përherë objektiv i drejtpërdrejtë i disinformimit rus, narrativat pro-Kremlinit kanë qarkulluar në mediat në vend me një ritëm më të lartë nga sa ishte raportuar më parë, gjë që sugjeron se mjedisi i informimit në vend nuk është imun.

Duke u mbështetur te gjetjet e këtij studimi, më poshtë jepen disa rekomandime për veprimet e nevojshme që duhet të ndërmerren në të ardhmen për të luftuar disinformimin në mediat në gjuhën shqipe:

- Mediat, redaktorët, gazetarët, studiuesit dhe kontrolluesit e fakteve duhet të rrisin njohuritë dhe kapacitetet e tyre për të identifikuar narrativat e përsëritura pro-Kremlinit, që qarkullohen nga ekosistemi mediatik i sponsorizuar nga shteti ose deklaratat e bëra nga institucionet dhe zyrtarët rusë përmes platformave të mediave sociale.
- Mediat duhet të rrisin ndërgjegjësimin për kërcënimin që vjen nga informacionet e rreme e të përsëritura ruse në Shqipëri.
- Mediat dhe kontrolluesit e fakteve duhet të bëjnë më shumë për të përgënjeshtuar si të pavërtetë propagandën disinformuese ruse që qarkullon në mediat në gjuhën shqipe.
- Është e nevojshme të trajnohen gazetarët, redaktorët dhe kontrolluesit e fakteve për të identifikuar narrativat e përsëritura të informacionit rus, në mënyrë që të eliminohen lajmet e rreme përpara se ato të publikohen ose të jepet konteksti e shpjegimi i nevojshëm për deklaratat me informacione të rreme të zyrtarëve rusë.



---

NARRATIVAT  
DISINFORMUESE RUSE NË  
MEDIAN **SHQIPTARE**



© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri (BIRN Albania)

Tiranë 2023